

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BORSH BAY” SH.P.K

Sot më datë, 21.01.2025 , në Lushnjë, ne shoqëritë :

1. **Shoqëria “LLAZO” sh.p.k**, e regjistruar pranë QKB me Nr.NIPT K24218401K, me seli në adresën: Fier, Lushnje, Bishqethëm 1, Rruga “Këmishtaj”, zona kadastrale 1197, nr pasurie 3/21, me Administrator Z. Aldi Llazi, me cilësinë e ortakut themelues ;
2. **Shoqëria “ADG” sh.p.k** , e regjistruar pranë QKB me Nr.NIPT K33804402L, me seli në adresën: Fshati Bishqethëm, Lagjia “Rruga e Kishes”, Autostrada Lushnjë – Fier Km 7, me Administrator Z. Arben Ndreka, me cilësinë e ortakut themelues ;

kemi redaktuar këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojmë se me vullnet të lire të plotë dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “ Për shoqëritë tregtare ” në ligjin “ Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, vendosëm të krijojmë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, **“BORSH BAY” sh.p.k**.

Neni 1 - Krijimi

Shoqëria **“BORSH BAY” Sh.p.k** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (këtu e më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2 -Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.


Shoqëria **“BORSH BAY” Sh.p.k**, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3 -Selia

1. Shoqëria e ka selinë në Adresën: Bashkia Lushnje, Njësia Administrative Kolonjë, Fshati Bishqethëm, Rruga “Këmishtaj”, Zona kadastrale 1197, Nr.pasurie 3/21.
2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4 - Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të biznesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



Neni 5 - Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt kryesor të veprimtarisë realizimin e projekteve të ndërtimit, shërbimeve të inxhinierisë civile, energjisë, mjedisit, si dhe ofrimin e shërbimeve teknologjike dhe industriale, përfshirë këtu studime, projekte, ndërtim dhe mirëmbajtje. Aktivitetet e shoqërisë përfshijnë, por nuk kufizohen në, fushat e mëposhtme:

1. Ndërtim dhe Infrastrukturë:

- a) Ndërtimi dhe rikonstrukcioni i rrugëve, autostradave, hekurudhave, urave, tuneleve, dhe veprave arti mbi dhe nëntokësore.
- b) Realizimi i veprave hidraulike dhe hidroteknike, përfshirë digat, ujesjellësat, gazsjellësat, porte dhe punime për mbrojtjen detare dhe lumore.
- c) Ndërtimi i strukturave parafabrikat dhe elementeve të ndryshme ndërtimi si hetonlarme, druri dhe metalike.
- d) Punime për germim dheu, pilota, diafragma, ankorime, mure mbajtëse, stabilizim skarpatesh dhe përforcim dhera.
- e) Prishja dhe demontimi i objekteve të ndryshme ndërtimore.

2. Prodhim dhe Furnizim Materialeve Ndërtimi:


- a) Prodhimi dhe furnizimi me beton, asfalto-beton, materiale plasëse dhe shpërthyes, si dhe produkte betoni të parafabrikuara (mure mbajtës, tombino, pllaka trotuari, bordura, kapakë, puseta, kuneta).
- b) Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit të gatshëm ose gjysmë të gatshëm si llac, kollë, fino, rërë, çimento dhe granit.

3. Energjitikë dhe Impiante Industriale:

- a) Projektimi dhe ndërtimi i impianteve të prodhimit të energjisë elektrike dhe/ose termike, përfshirë hidrocentrale, termocentrale, impiante fotovoltaike, eolike dhe sisteme energjetike.
- b) Projektimi dhe ndërtimi i nënstacioneve, kahinave dhe rrjeteve të tensionit të lartë, të mesëm dhe të ulët.
- c) Projektimi dhe realizimi i sistemeve të energjisë dhe mirëmbajtja e impianteve energjetike.

4. Shërbime Industriale dhe Teknologjike:

- a) Automatizim industrial, instalimi dhe mirëmbajtja e makinerive dhe pajisjeve elektrike, mekanike, elektronike, si dhe sistemeve të sigurisë dhe kontrollit.
- b) Ndërtimi dhe mirëmbajtja e impianteve frigoriferike për prodhimin dhe përpunimin e produkteve ushqimore, bujqësore dhe industriale.
- c) Projektimi dhe ndërtimi i sistemeve të kondicionimit, ngrohjes dhe ftohjes, si dhe sistemeve kundra zjarrit dhe të aspirimit.



5. Shërbime Mjedisore dhe Trajtimi i Ujërave:

- a) Punime dhe projekte për trajtimin e ujërave të pijshme dhe të ndotura, si dhe ndërtimi i sistemeve të kanalizimeve dhe pastrimit të ujërave.
- b) Grumbullimi, transportimi dhe trajtimi i mbetjeve të ndërtimit, mbetjeve industriale dhe të ngurta urbane.
- c) Riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve të ndryshme të natyrës dhe operacione për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme.

6. Konsulencë dhe Projektim:

- a) Projektim Arkitektonik dhe Inxhinierik: Projektim arkitektonik, konstruktiv dhe hidrosanitare për ndërtimin e objekteve civile dhe infrastrukturore si rrugë, ura, tunele dhe ndërtesa.
- b) Projektim i Veprave Hidraulike dhe Hidroteknike: Projektimi dhe studimi i veprave hidraulike, si digat, ujesjellësat, gazsjellësat, sistemeve për mbrojtjen detare dhe lumore.
- c) Projektim dhe Studim për Energji: Projektimi i impianteve të prodhimit të energjisë elektrike dhe/ose termike, përfshirë hidrocentrale, termocentrale, impiante fotovoltaike dhe eolike.
- d) Projektim dhe Inxhinieri për Infrastrukturë: Projektimi dhe ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, urave dhe tuneleve.
- e) Projektim për Sisteme Industriale dhe Teknologjike: Projektimi dhe instalimi i sistemeve të automatizimit industrial, pajisjeve, makinerish dhe sistemeve të ndryshme të sigurisë, elektrike, mekanike dhe elektronike.
- f) Konsulencë dhe Projektim për Mjedisin dhe Menaxhimin e Ujërave: Projektimi i sistemeve për trajtimin e ujërave të pijshme, kanalizimeve, riciklimit dhe trajtimit të mbetjeve.
- g) Konsulencë dhe Studime për Burime Natyrore: Konsulencë dhe projektim për shfrytëzimin e burimeve minerale, hidrokarbureve, energjisë, burimeve të ujërave minerale dhe termale.
- h) Projektim dhe Studime për Ndërtesa të Mëdha dhe Infrastruktura të Rëndësishme: Konsulencë dhe projektim për objekte me ngarkesa të mëdha si hidrocentrale, aeroporte, porte, bazamente dhe objekte me shumë kate.
- i) Projektim Fotogrametrik dhe Topografik: Studime dhe projektim fotogrametrik-hartografik, topografik dhe gjeodezik, si dhe rlevime për objekte dhe infrastrukturë të ndryshme.

7. Veprimtari të Tregtisë dhe Shërbimeve:

- a) Tregtim i materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit: Tregtim me shumicë dhe pakicë të makinerive, pajisjeve dhe materialeve të ndërtimit, industriale, elektroshtëpiake, hidraulike, elektrike, elektronike dhe bujqësore.
- b) Import-eksport dhe tregti online: Import-eksport dhe tregti online i produkteve të ndryshme, duke përfshirë materialet e ndërtimit, makineri dhe pajisje.
- c) Shërbime publiciteti dhe marketingu: Veprimtari dhe shërbime të ndryshme publiciteti, reklamimi dhe promocioni.



8. Veprimtari të Transportit dhe Logjistikës:
- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar i mallrave me mjetet e shoqërisë, për llogari të saj dhe të të tretëve, si dhe transport të mallrave jashtë norme dhe shoqërim teknik të tyre.
 - Dhënie me qera të makinerive të rënda, pajisjeve dhe impjanteve teknologjike.
 - Shërbime peshëmatje dhe autoservis për autovetura, kamionë dhe makineri të rënda.
9. Veprimtari të Ndryshme Financiare dhe Konsulencë:
- Financim dhe investim në sipërmarrje të ndryshme, shërbime të pagesave dhe transferimit të parave, parasë elektronike dhe operacione komisioner.
 - Zhvillim të programeve/software të teknologjisë së informacionit.
 - Aktivitetet e shërbimeve imobiliare, si shit-blerje dhe/ose qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.
 - Krijimi dhe menaxhimi i qendrave të të dhënave elektronike, instalim dhe tregtimi i sistemeve të sigurisë.
 - Shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion tjetër komercial, industrial, dhe financiar, të dobishëm ose plotësues për përmbushjen e objektit të shoqërisë, me kusht që aktivitetet e saj të mos jenë në kundërshtim me objektin kryesor të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 6 - Kapitali themeltar



1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 400.000 (katërqind mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 kuota, vlera nominale e të cilave janë:
- Shoqëria "LLAZO" sh.p.k**, e regjistruar pranë QKB me Nr.NIPT K24218401K, zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit, e barabartë me 50% të vlerës së kapitalit të Shoqërisë.
 - Shoqëria "ADG" sh.p.k**, e regjistruar pranë QKB me Nr.NIPT K33804402L, zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit, e barabartë me 50% të vlerës së kapitalit të Shoqërisë.

të zotëruara nga ortakët e shoqërisë, kuota këto me vlerë të përgjithshme 400.000 (katërqind mijë) Lekë, të cilat përbëjnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Secila kuotë është në vlerën 200.000 (dyqind mijë) Lekë.
- Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.
- Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7 - Organi Vendimmarrës

- Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.



3. Asambleja e ortakëve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët, të cilët mund të përfaqësohen edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.
4. Administratorët – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Neni 8 - Ndryshimet e Statutit

1. Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e ortakëve.
2. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB –së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 9 - Administrimi

1. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.
2. Asambleja e ortakëve vendos për sistemin e administrimit dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcakton numrin e tyre dhe kompetencat.
3. Administratori/rët, mund të jenë ose jo ortakë.
4. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.
5. Administrator i shoqërisë është Z. Aldi LLAZI, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare sipas ligjit.

Neni 10

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 11 -Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi pasi u redaktua dhe lexua nga ortakët themelues, miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare dhe nënshkruhet prej tyre.

ORTAKËT THEMELUES

Shoqëria "LLAZO" sh.p.k

Përfaqësuar nga

Aldi LLAZI



Shoqëria "ADG" sh.p.k

Përfaqësuar nga

Arben NDREKA



